



VENDIM

Nr. 73, Datë 16.05.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “C.G.C” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 107; nenit 22 pika 2 gërma “ç”; nenit 83 pika 1 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; neneve 4, pika 1, gërma “ç”; neni 10 dhe 11 të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr.9, datë 11.02.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.05.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C.G.C” SH.P.K, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit të shoqërisë “C.G.C” sh.p.k.

Konstatohet se:

- Formati dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), janë plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni Ligjor, (neni 9, pika 1, gërma “d”/i, d/ii, (akti i rregjistrimit dhe struktura organizative), janë plotësuar në mënyre korrekte,
- Gërma: e/vii(garanci e preformancës) është plotësuar.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, gërma e/i, e/ii, sasia e gazit në Nm³ dhe garancia e cilësisë së gazit), janë plotësuar mënyrë korrekte.
- Dokumentet specifike për llojin e licencës (Neni 9 pika 2 gërma e/iii garancia financiare), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “C.G.C” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI